

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat e Kosovës



RAPORTI I MISIONIT

mbi

2.1.1 Vlerësimin dhe azhurnimin e planit të veprimit

Komponenti nr. 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Clementina Ivan-Ungureanu and Timmi Graversen,
Statistikat e Danimarkës

6-10 Janar 2014

Versioni nr 01/Final

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +
Email: iu_clem@yahoo.com

Timmi Graversen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 38 65
Email: trg@dst.dk

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme.....	5
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	5
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	13
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	16
Aneksi 2. Personat e takuar	20

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Kombëtare Vjetore
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
NOE	Ekonomia e pavrojtuar
R& D	Kërkimi dhe Zhvillimi
SIDA	Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Nderkombëtar
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruse-Përdoruese
TeR	Termat e Referencës

Përmbledhje Ekzekutive

Misioni i parë në kuadër të komponentit të dytë – Objektivat kryesore të këtij misioni në Projektin e Binjakëzimit kanë qenë vlerësimi i situatës së tanishme dhe azhurnimi i planit të veprimit.

Në fushën e llogarive kombëtare, ASK-ja është e përfshirë në projektin multi-përfitues të IPA 2011 dhe është përfituese e asistencës teknike të FMN-së. Në projektin IPA 2011, ASK-ja ka dy objektiva kryesore: implementimin e ESA 2010 dhe implementimin e llogarive kombëtare në baza tremujore; asistenca teknike e FMN-së do të përkrahë përmirësimin e llogarive kombëtare vjetore me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve, dhe me çmimet aktuale dhe konstante.

Vlerësimet preliminare në lidhje me kërkimin dhe zhvillimin (R&D), shpenzimet ushtarake, outputin e Bankës Qendrore, aktivitetin e sigurimeve dhe BPV-ne tremujore për periudhën 2010 – tremujorin e dytë 2013 do të jenë të gatshme në Maj të vitit 2014, kur përfundon dhe projekti. Asistenca teknike e FMN-së do të vazhdojë deri në Qershor; në këto rrethana, Projekti i Binjakëzimit do të ketë rolin kryesor në mbështetjen e zhvillimit të llogarive kombëtare në baza vjetore dhe tremujore në Kosovë për vitet 2014 dhe 2015.

Plani i veprimit është përpunuar duke pasë parasysh projektet që janë duke u zhvilluar dhe planin e punës të ASK-së për vitin 2014, që është planifikuar në vitin paraprak. Qëllimet janë caktuar duke u bazuar në angazhimet aktuale dhe objektivat e Projektit të Binjakëzimit. Përmbushja e tyre nuk varet vetëm nga zhvillimi i llogarive kombëtare mirëpo edhe nga progresi në fushat e tjera statistikore, si statistikave strukturore dhe ato afat shkurta, çmimet, statistikave sociale (Anketa e Buxhetit të Ekonomisë Familjare dhe Anketa e Fuqisë Punëtore) si dhe qasja në burimet e të dhënave administrative. Plani i veprimit është shumë ambicioz si i vetem dhe varet nga zhvillimi dhe disponueshmëria e statistikave primare, që kërkohen nga ky plan i llogarive kombëtare.

Ne besojmë që një objektiv i realizueshëm operacional afat-mesëm për Departamentin e Llogarive Kombëtare do të ishte prodhimi i rregullt i llogarive kombëtare në përputhje me tabelën 1 të programit të transmetimit ESA 2010.

1. Komentet e përgjithshme

Raporti i misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat e Kosovës'. Është misioni i parë në kuadër të komponentit të dytë të projektit që i kushtohet Llogarive Kombëtare. Qëllimi i misionit ka qenë definimi i planit strategjik si bazë për implementimin e mëtejshëm të projektit në këtë fushë statistikore.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Azhurnimi i planit të veprimit dhe asistimi i ASK-së në zgjerimin e planit të veprimit në një plan operativ afat-mesëm.

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve të tjerë (NI-CO/Statistikat e Finlandës/Istat/Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Stafi i llogarive kombëtare ka paraqitur gjendjen aktuale dhe e ka diskutuar atë me konsulentët gjatë ditëve të para të misionit.

Publikimi i fundit në web faqen e ASK-së perfshin BPV-ne me qasjen e shpenzimeve në çmimet aktuale për periudhën 2004 – 2012, në çmimet konstante për periudhën 2006 – 2012, BPV-ne me qasjen e prodhimit në çmimet aktuale dhe konstante 2006 – 2012. Gjithashtu janë përpunuar tabelat ofruese-përdoruese (SUT), prodhimi dhe gjenerimi i llogarise se të ardhurave për sektorët institucionale për vitet 2005, 2006 dhe 2007 por nuk është bërë azhurnimi i këtyre vlerësimeve. Akoma nuk ekziston një përpilim dhe publikim i integruar i BPV-së vjetore bazuar në qasjen e shpenzimeve dhe të prodhimit dhe i llogarive kombëtare tremujore. Ekziston një hendek në mes të vlerësimeve të BPV-së me qasjen e shpenzimeve (të dhënat për vitin 2012 janë publikuar në Shtator të vitit 2013) dhe BPV-së me qasjen e prodhimit (të dhënat për të njëjtin vit janë publikuar në Dhjetor të vitit 2013).

Më poshtë, në tabelën 1, është paraqitur Plani i Veprimit i vitit 2010 i azhurnuar, me komentet përkatëse.

Tabela 1: Pikat kryesore të Planit të Veprimit të ASK-së i datës 27 Shtator 2010

Në kolonën e parë janë paraqitur numrat rendorë, në kolonën e dytë dhe të tretë është plani i veprimit original i vitit 2010. Kolona e katërt paraqet fazën aktuale dhe në kolona e pestë propozimet e këtij misioni.

Nr	Veprimi	Periudha	Përmbushja Janar 2014	Rishikimi i objektivave për 2014
1	Vlerësimi dhe publikimi në të njëjtën kohë i BPV-së me qasjen e prodhimit dhe me qasjen e shpenzimeve për vitet 2009, 2010.	2012	Jo	Plani operativ 1.2 (2008-2012)
2	Përmirësimi i vlerësimit të GFCF në vijë me metodologjinë e ESA95.	2011	Jo	Plani operativ 1.1
3	Përmirësimi i vlerësimeve të llogarive të sektorëve institucionale	2012	Jo	-
4	Vlerësimi i konsumit të kapitalit fiks në sektorin e përgjithshëm të qeverisë duke përdorur informacione të detajuara nga burimet e të dhënave.	2011	Jo	Plani operativ 1.1
5	Përmirësimi i ndryshimeve në vlerësimin e inventarit sipas aktivitetit/sectorit dhe sipas llojitt (puna në proces, produktet finale, produktet për rishitje, lënda e parë dhe furnizimet.	2011	Jo	-
6	Përmirësimi i vlerësimit të indikatorëve të llogarive kombëtare bujqësore duke integruar rezultatet e Zonës Ekonomike Evropiane	2011	Kalkulimet e bëra për 2012, por nuk janë të integruara në BPV	Plani operativ 1.2
7	Përpunimi i SUT për 2009 sipas çmimeve aktuale dhe konstante.	Fundi i 2012	Jo	SUT për vitin 2013 në dispozicion në fund të 2015
8	Implementimi i statistikave afatshkurta, kryesisht për të mbledhur informata rreth qarkullimit sipas aktiviteteve, shpenzimeve, investimeve, pagave dhe numrit të punësuarve.	2011	Jo	Plani operativ 2.4
9	Kalkulimi preliminar i BPV-së tremujore	2011	Kalkulimet e brendshme preliminare me qasjen e prodhimit për 2010-2011 pothuajse kane perfunduar . BPV tremujore me qasjen e shpenzimeve për këtë periudhë si dhe vlerësimet per 2012 janë në proces.	Plani Operativ 2.1 2010q1-2013q2
10	Përmirësimi i vlerësimit të ekonomisë së pavrojtuar bazuar në burimet e të dhënave në dispozicion dhe në formën tabelare.	2013	Disa kalkulime preliminare (metoda e fuqisë punëtore) për 2012 janë në proces	Plani Operativ 1.1
11	Zhvillimi i llogarive kombëtare tremujore	2012-2014	Jo	Plani Operativ 2.4, 2.5 and 2.7
12	Vlerësimi i BPV-së vjetore me qasjen e të ardhurave sipas aktiviteteve	2014	Jo	-
13	Vlerësimi i konsumit të kapitalit fiks sipas metodës PIM	2012-2014	Jo	-

14	Alokimi i FISM sipas sektorëve dhe përdoruesve duke u bazuar në gjendjen aktuale në Kosovë.	2012-2014	Kalkulimet e përgatitura ende nuk janë integruar në BPV	Plani Operativ 1.1
15	Pjesëmarrja e gjithë stafit në trajnime në fushën e llogarive kombëtare	Vazhdimi sht		-
16	Implementimi i njohurive të fituara gjatë trajnimeve në praktikën aktuale të përpilimit të llogarive kombëtare.	Vazhdimi sht		-
17	Përmirësimi i njohurive të stafit në gjuhët e huaja (sidomos në gjuhën angleze) mundëson qasjen në metodologjitë ndërkombëtare në fushën e llogarive kombëtare.	Vazhdimi sht		-

Disa prej komponentëve të paraqitura në tabelën 1 janë në proces zhvillimi dhe angazhimet në kuadër të projekteve paraprakisht të aranzhuara me BE-në dhe FMN-në janë të mëdha. Gjithashtu, harta rrugore e ASK-së e publikuar për vitin 2014 është mjaft ambicioze për sa i perket rezultateve të pritura në llogaritë kombëtare.

Në kuadër të planeve për këtë vit pritet:

- Të implementohet ESA2010 deri në Shtator 2014;
- Të konvertohet nga NACE rev. 1 në NACE rev. 2 deri në Shtator 2014;
- Të integrohet qasja e shpenzimeve me qasjen e prodhimit dhe
- Te publikohet për herë të parë në fund të vitit 2014 BPV-ja tremujore me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve, me çmimet aktuale dhe konstante me të dhënat për periudhën 2010-2013 dhe tremujorin e parë të vitit 2014.

Duke marrë parasysh situatën aktuale dhe burimet njerëzore në dispozicion, mundësitë për zgjerimin e aktiviteteve jashtë atyre të planifikuara do të jenë të kufizuara. Rritja e numrit të stafit në Departamentin e Llogarive Kombëtare është e nevojshme, sidomos në këtë periudhë kur janë duke u implementuar llogaritë kombëtare tremujore dhe duhet të realizohet tranzicioni në ESA 2010.

Shumica e projekteve që janë duke u zhvilluar (IPA 2011 dhe projekti IPA 2012 dhe projekti i FMN-së në të ardhmen) nuk janë në kundërshtim me njëri tjetrin mirëpo përshtypja e parë është që aktivitetet e tyre janë disi të fragmentuara. Gjithashtu ka shumë lidhshmëri midis komponentëve të projekteve për zhvillimin e llogarive kombëtare dhe ekziston nevoja që këto projekte dhe objektiva të koordinohen dhe planifikohen për të siguruar lëvizjen e tyre në të njëjtin drejtim.

Ne besojmë që një objektiv i realizueshëm operacional afat-mesëm për Departamentin e Llogarive Kombëtare do të ishte prodhimi i rregullt i llogarive kombëtare në përputhje me tabelën 1 të programit të transmetimit ESA 2010.

2.3 Plani i propozuar për aktivitetet në vitin 2014

Lidhshmëria e të gjitha projekteve që janë duke u zhvilluar dhe rezultatet e pritura janë diskutuar me stafin dhe është zhvilluar një plan operativ (tabela nr.2) që fokusohet në aktivitetet për vitin 2014. Jemi munduar të përpilojmë një plan sa më realist për të gjitha aktivitetet dhe objektivat, që do të zhvillohen në Departamentin e Llogarive Kombëtare për vitin 2014. Si rezultat, plani përfshin punën që është duke u bërë si pjesë e programeve të mëparshme të përkrahjes, projektet që janë duke u zhvilluar aktualisht dhe hartën rrugore 2014 të ASK-së. Ne kemi marrë në konsideratë lidhshmërinë e komponentëve në mënyrë që

finalizimi i tyre të bëhet sipas rendit të paraqitur mëposhtë duke qenë se projektet aktuale duhet të mbështeten në rezultatet e projekteve të kaluara.

[illegible]

Aktiviteti 1. Përmirësimi i Llogarive Kombëtare Vjetore

1.1 Implementimi i ESA 2010:

Implementimi i ESA 2010 përfshin: vlerësimin e kërkimit dhe zhvillimit (R&D), shpenzimeve ushtarake, vlerësimin e outputit të Bankës Qendrore, aktiviteteve të sigurimit dhe vlerësimin e një pjese të ekonomisë së pavrojtuar duke u bazuar në metodën e fuqisë punëtore. Të gjitha këto përmirësime janë në proces dhe përbëjnë objektivat e përfshira në programin multi-përfitues të IPA 2011 dhe në programet e tjera, që përkrahen nga FMN-ja. Vlerësimet e reja bazuar në metodologjinë e ESA 2010 do të bëhen për periudhën 2010-2012 dhe do të integrohen në llogaritë ekzistuese për të siguruar transmetimin sipas ESA 2010 në Eurostat, në Shtator të vitit 2014.

1.2 Rishikimi i Llogarive Kombëtare Vjetore- 2008-2012 (projekti i FMN-së) me të dy qasjet, çmimet aktuale dhe konstante, bazuar në ESA2010, NACE rev.1

Eshtë planifikuar një mision i FMN-se në Mars/Prill me qëllim të rishikimit dhe integritetit të qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve të llogarive kombëtare vjetore si dhe përfshirjen e rezultateve të reja për sektorin financiar.

1.3 Shndërrimi në NACE rev.2 për BPV 2008-2012 (nëse tabela përkatëse është e gatshme në Qershor 2014)

Pjesë e transmetimit në ESA2010 është konvertimi i vlerësimeve të mëparshme të llogarive kombëtare në NACE rev. 2. Procesi i konvertimit në vetvete bëhet vetëm në anën e prodhimit dhe nuk duhet të ketë efekt në BPV-ne dhe VSHB-ne (Gross added value GVA) e përgjithshme. Kjo mund të përdoret si kontroll në kalkulime. Rekomandohet që ky transformim të realizohet si proces i ndarë, i pavarur nga ndryshimet e tjera, që të sigurohet se mund të bëhet kontrollimi i BPV së përgjithshme para se të vazhdohet me përpilimin e proceseve të tjera. Ky aktivitet mbështetet shumë në një urë kalimi midis NACE rev. 1 dhe rev. 2. Çelësi i këtij kalimi/shndërrimi mbështetet në informacionet me kode të dyfishta dhe të rishikuara mbi industrinë në Anketën Strukturore të Ndermarrjeve (ASN) për 2013. Në mënyrë që të realizohet shndërrimi i BPV-së me qasjen e prodhimit në NACE rev.2 para transmetimit të të dhënave në Eurostat (Shtator 2014), është e nevojshme që këto informacione të sigurohen nga ana e Departamentit Ekonomik të ASK-së deri në Qershor të këtij viti.

1.4 BPV 2013 me qasjen e shpenzimeve bazuar në ESA 2010; publikimi i rezultateve

Plani i punës i përpunuar vitin e kaluar nga ana e ASK-së dhe i aprovuar nga Qeveria ka parashikuar vlerësimin e BPV-se vjetore me qasjen e shpenzimeve, të gatshëm në Shtator, dhe me qasjen e prodhimit në Nëntor të vitit 2013. Kjo hapësirë kohore midis publikimeve është akoma e evidente. Një prej objektivave të Projektit të Binjakëzimit do të jetë vlerësimi dhe publikimi i BPV-së me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve në të njëjtën kohë në një formë të balancuar; kjo do të mund të realizohet në vitin 2015. Plani i veprimit i paraqitur në tabelën 2 është në vijë me planin e punës të ASK-së dhe, bazuar në këtë, vlerësimi i BPV-se me qasjen e shpenzimeve 2013 do të jetë i gatshëm në Shtator 2014. Këtë herë kjo duhet të bazohet në kornizën e ESA 2010 për llogaritë kombëtare vjetore.

1.5 BPV 2013 me qasjen e prodhimit bazuar në ESA 2010, NACE rev.2; publikimi i rezultateve

Vlerësimet e tanishme të BPV-së me qasjen e prodhimit për vitin 2013 do të bazohen në ESA 2010 duke përdorur NACE rev.2.

1.6 BPV 2014 me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, ESA 2010

Sic përmendet më lart, prodhimi i integruar dhe publikimi në të njëjtën kohë i BPV-së sipas shpenzimeve dhe prodhimit do të duhej të realizohej në vitin 2015. Plani i punës do të detajohet dhe më tej, duke marrë parasysh objektivat dhe rrethanat; rezultatet preliminare do të mund të publikoheshin në fund të Marsit 2015 duke u bazuar në të dhënat tremujore, ndërsa një version i përkohshëm në Shtator 2015, nëse statistikatat e ASN-së do të jenë të gatshme me kohë.

Aktiviteti 2. BPV-ja tremujore

ASK-ja zhvillon një aktivitet intensiv për implemetimin e llogarive kombëtare tremujore. Aktiviteti ka filluar në fillim të vitit 2013, në kuadër të programit multi-përfshirës IPA 2011. Procesi i implementimi ka filluar me vlerësimin e BPV-se tremujore me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve për vitet 2010-2012, për të cilat kane qene të gatshme të dhënat vjetore. Analiza e rezultateve do të përdoret për të caktuar metodologjinë e vlerësimit në kohë reale të BPV-se tremujore, duke u bazuar në burimet e të dhënave që janë në dispozicion. Në kuadër të projektit IPA 2011, do të prezantohen rezultatet preliminare për 2 tremujorët e parë të vitit 2013.

Plani i veprimit i aprovuar gjatë misionit nga stafi dhe menaxhmenti i Departamentit të Llogarive Kombëtare, dhe i paraqitur në tabelën 2, merr në konsideratë objektivat e IPA 2011 dhe planin e punës ekzistues të ASK-se në lidhje me publikimin e të dhënave tremujore.

2.1 Finalizimi i BPV-ve tremujore për periudhën tremujori 1 i 2010- tremujori 2 i 2013, në të dy qasjet, çmimet aktuale dhe konstante, bazuar në Llogaritë Kombëtare Vjetore të vjetra, NACE rev.1

Ky aktivitet është në proces në kuadër të projektit IPA 2011. Metoda e kalkulimit të rezultateve ekzistuese për 2010 - 2012 me qasjen e prodhimit kryesisht bazohet në shpërndarjen e rezultateve ekzistuese vjetore në tremujorë duke përdorur indikatorët tremujorë në dispozicion. Për të kalkuluar tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2013 do të duhet të bëhet projektimi i rezultateve nga viti 2012 duke përdorur indikatorët tremujorë.

2.2 Përfundimi i BPV-se tremujore për 2010-2013, në të dy qasjet, çmimet aktuale dhe konstante bazuar në ESA 2010, NACE rev.1

Vlerësimet e reja për ESA 2010 të elaboruara për llogaritë vjetore do të integrohen në të dhënat tremujore; në këtë drejtim, serite kohore të BPV-së tremujore për periudhën 2010-2013 do të rishikohen në baze të të dhënave vjetore. Kjo paraqet hapin e parë të procesit të rishikimit.

2.3 Shndërrimi në NACE rev. 2 për BPV-ne tremujore 2010-2013

Hapi i dytë i procesit të rishikimit është rishikimi i serive kohore tremujore duke implementuar NACE rev.2. Shndërrimi i të dhënave tremujore do të përcjellë rishikimet e llogarive kombëtare vjetore.

2.4 Krijimi i metodologjisë së vlerësimit të BPV-se tremujore (metoda e indikatoreve)

2.5 Vlerësimi i BPV-se tremujore 2013 dhe IQ 2014, qasja e prodhimi dhe shpenzimeve, ESA2010, cmimet aktuale dhe konstante, NACE rev.2

2.6 Publikimi i BPV-se tremujore 2010-2013 dhe IQ 2014

Një hap i rëndësishëm në implementimin e llogarive kombëtare tremujore është përcaktimi i metodologjisë së vlerësimeve. Metodologjia do të definohet duke u bazuar në burimet e të dhënave mujore dhe tremujore që janë në dispozicion dhe analizën e vlerësimeve të para të BPV-se tremujore për periudhën 2010-2013. Kjo do të të përdoret për rishikimin e vlerësimeve preliminare të vitit 2013 dhe vlerësimin e llogarive për tremujorin e parë të vitit 2014. Rezultatet do të publikohen në fund të vitit duke u bazuar në planin e punës të ASK-së.

2.7 Vlerësimet e tanishme të BPV-se tremujore 2015 (IQ- IIQ)

Në bazë të planit të punës, duke filluar nga viti 2015, do të bëhen vlerësimet për BPV-ne tremujore dhe diseminohen në prodhimin aktual; normalisht afati do të jetë 90 ditë pas përfundimit të periudhës. Arritja e këtij objekti varet nga cilësia dhe disponueshmëria e burimeve të të dhënave administrative dhe statistikore.

Aktiviteti 3 – Përpunimi i Tabelave Ofruese-Përdoruese (SUT)

ASK-ja ka vlerësuar dhe publikuar SUT për vitet 2005-2007, me çmimet aktuale dhe konstante. Dy SUT e para janë përpunuar në kuadër të projektit IPA “Përkrahje e mëtejme për Zyrën e Statistikave të Kosovës” i realizuar gjatë periudhës 2007-2009. Pas përfundimit të projektit, ASK-ja ka përpunuar SUT për vitin 2007 me çmimet aktuale dhe konstante, por ky aktivitet nuk ka vazhduar më pas. SUT paraqet një mjet të rëndësishëm për përmirësimin e llogarive kombëtare në baza tremujore dhe vjetore. Për këtë arsye mund të merret në konsideratë që me përkrahjen e Projektit të Binjakëzimit të bëhet përpilimi i SUT për vitin 2013. Në mënyrë që të sigurojmë të dhënat e nevojshme, duhet të bëhet përmirësimi i ASN-së për vitin 2013. Përgatitjet për këtë mund të fillojnë në 2014, por pjesa më e madhe e aktivitetit të SUT duhet të bëhet gjatë vitit 2015.

Aktiviteti 4. Përmirësimi i metodologjisë dhe matjet statistikore të ekonomisë së pavrojtuar

Në fund të vitit të kaluar, ASK-ja ka pasur përkrahjen e IPA 2011 në përpilimin e planit të veprimit për vlerësimin e ekonomisë së pavrojtuar duke u bazuar në qasjen tabelare të Eurostatit. Vlerësimi i llojeve të ekonomisë së pavrojtuar (N1 deri N6) varet nga burimet e të dhënave administrative dhe statistikore, që janë në dispozicion. Aktualisht, për shkak të mungesës së burimeve të të dhënave, plani i veprimit përfshin disa mundësi për mbulimin e llojeve të ndryshme të ekonomisë së pavrojtuar duke bërë anketa të vecanta me ekonomite familjare dhe ndërmarrjet ose duke aplikuar metoda të ndryshme, me përdorimin e burimeve të të dhënave ekzistuese. Bazuar në këtë plan, ASK-ja është duke shikuar të gjejë përkrahje financiare nga donatorët për realizimin e këtyre anketave; ndërkohë ekspertët e Departamentit të Llogarive Kombëtare kanë filluar me mbledhjen e të dhënave të mundshme për vlerësimin e aktiviteteve të drogës dhe integrimin e këtyre të dhënave në rezultatet e llogarive kombëtare.

Këto vlerësime mund të bëhen gjatë këtij viti dhe do të përbëjnë një pjesë të implementimit të ESA 2010. Këto aktivitete duhet të realizohen në vitin 2014 aq sa është e mundur që të arrihet përfundimi i tyre me kohë për t'i integruar në përpilimin e Llogarive Kombëtare (aktiviteti 1.4 dhe 1.5). Zgjerimi i aktiviteteve të mbledhjes së informacioneve të reja dhe sterngarkimi në këtë fushë nuk duhet të tërheqë resurset nga komponentet e tjera të Departamentit të Llogarive Kombëtare por duhet të shtyhen në vitin 2015. Një përmirësim tjetër që do të bëhet në kuadër të projektit IPA 2011 është në lidhje me vlerësimin e ekonomisë së pavarëzuar duke u bazuar në metodën e fuqisë punëtore për 2012 (aktiviteti 1.1). Kjo metodë mund të aplikohet sepse duke filluar nga viti 2012 Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) realizohet në baza tremujore me nxjerrje të rezultateve në lidhje me vlerën mesatare vjetore të punësimit në Kosovë sipas aktiviteteve, bazuar në NACE rev.2.

3. Konkluzionet dhe përfundimet

Plani i punës për 2014 përfshin edhe detyra nga projektet e kaluara prandaj kemi vendosur të bëjmë një plan operativ për llogaritë kombëtare për 2014 që merr parasysh këto aktivitete. Përveç kësaj kemi paraqitur propozimet për komponentet në Planin e Veprimit për 2015 mirëpo planifikimi më i detajuar duhet të bëhet deri në fund të vitit 2014 duke marrë në konsideratë progresin e arritur gjatë vitit 2014.

Është rekomanduar që plani operativ i Departamentit të Llogarive Kombëtare të ndahet në komponente më të vogla dhe këto t'u caktohen punonjësve vec e vec. Poashtu është rekomanduar përcjellja nga afër e zhvillimit të proceseve.

Është rekomanduar që përpilimi i urave të shndërrimit midis NACE rev.1 dhe rev.2 në Anketen Strukturore të Ndermarrjeve (ASN) dhe divizionin e regjistrit të bizneseve të përshpejtohet dhe të përfundojë deri në Qershor 2014. Nëse kjo nuk mund të realizohet, i tërë plani i punës i propozuar do të shtyhet.

Është rekomanduar që rregullimet në pyetësin e Anketes Strukturore të Ndermarrjeve (ASN) për vitin 2014 të diskutohen dhe të koordinohen me Departamentin e Llogarive Kombëtare në mënyrë që të sigurojë të dhënat e nevojshme për përpilimin e llogarive kombëtare dhe vlerësimin e tabelave ofruese-përdoruese (SUT) të vitit 2013.

Është rekomanduar të përmirësohen statistikat afat shkurta në aspektin e përmbajtjes dhe afatit të diseminimit që të jenë në dispozicion dhe më të dobishme për t'u përdorur për vlerësimin e llogarive kombëtare tremujore.

Numri i stafit është rritur në shtatë. Ky numër do të rritet edhe për katër punonjës të tjerë gjatë këtij viti (dy persona do të punësohen nga SIDA dhe dy persona nga ASK-ja). Rritja e resurseve njerëzore normalisht do të rrisë mundësitë e realizimit të detyrave nga ana e Departamentit të Llogarive Kombëtare. Poashtu është mjaft e rëndësishme për menaxhmentin të kuptojë që dyfishimi i numrit të punëtorëve gjatë viteve të ardhshme do të jetë sfida. Është e rëndësishme të orientohen përpjekjet e menaxhmentit në drejtim të realizimit të potencialit të plotë të punonjësve të rinj. Disa prej metodave mund të jenë: të ndahen disa nga detyrat më të mëdha në më të vogla; punonjësit me përvojë të mbikëqyrin punonjësit me më pak përvojë; të përcillet performanca përmes raportimit javor etj. Pavarësisht se si realizohet kjo, është e rëndësishme të kuptohet se menaxhmenti ka këtë detyrë specifike shtesë të realizimit të potencialit të plotë të resurseve shtesë.

Lista e qëllimeve të propozuara:

- i. Vlerësime gjithëpërfshirëse prej tremujorit 1 të vitit 2010 – tremujori 2 të vitit 2013 në bazë të ESA95, NACE rev. 1, me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante
Afati: Maj 2014
- ii. Implementimi i ESA 2010; rishikimi i llogarive vjetore për periudhën 2010-2012
Afati : Shtator 2014
- iii. Vlerësimi i BPV-së vjetore 2013 me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante
Afati: Shtator 2014
- iv. Vlerësime gjithëpërfshirëse tremujore për 2010-2013 bazuar në ESA2010, NACE Rev. 2, me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante
Afati: Tetor 2014
- v. Vlerësimi i BPV-se vjetore 2013 me qasjen e prodhimit, me çmime aktuale dhe konstante
Afati: Nëntor 2014
- vi. Publikimi i BPV-se tremujore 2010-2013 dhe tremujorit të parë 2014, bazuar në ESA 2010 dhe NACE rev.2
Afati: Dhjetor 2014/

Rreziqet

Duke pasur parasysh vonesat aktuale në realizimin e objektivave të Planit të Veprimit 2010, aktivitetet e caktuara në Hartën Rugore të ASK-së për vitin 2014 janë shumë ambicioze dhe si të tilla paraqesin rrezik. Rreziqet, që duhet të merren për bazë janë:

- Humbja e fokusit dhe shpërndarja e aktivitetëve në shumë çështje – duke përfshirë edhe marrjen e obligimeve nga projektet e reja.
- Shndërrimi në NACE rev. 2 varet nga përfundimi i shndërrimit të regjistrit të biznesit dhe ASN-se dhe përgatitjen e urës kaluese në mes të NACE rev.1 dhe 2. Ky projekt ende është në proces.
- Aktualisht rezultatet në llogaritë kombëtare tremujore janë të bazuara vetëm në shpërndarjen tremujore të shifrave vjetore ekzistuese. Akoma nuk është zhvilluar një metodë dhe sistem për prodhimin e vlerësimeve të tanishme në kohë për tremujorët e fundit dhe kjo varet nga disponueshmëria dhe cilësia e burimeve të të dhënave administrative dhe statistikore.

Misionet e propozuara:


- Përmirësimi i përgatitjes së ASN-se dhe Tabelave Ofruese-Përdoruese (SUT), (veprimi 3.1)
- Llogaritë kombëtare tremujore: Përkrahja për përfundimin e dhënave prej tremujorit 1 të 2010- tremujori 2 të 2013, ESA95, NACE rev. 1 (veprimi 2.1)
- Shndërrimi prej NACE rev.1 në NACE rev.2 (veprimet 1.3 Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe 2.3 Llogaritë Kombëtare tremujore)
- Sistemi i vlerësimeve për llogaritë kombëtare tremujore, bazuar në indikatorë (veprimi 2.4)

- Përkrahja e përpilimit të BPV-së vjetore 2013 me qasjen e shpenzimeve (veprimi 1.4)
- Përkrahja e përpilimit të BPV-së vjetore 2013 me qasjen e prodhimit (veprimi 1.5)
- Përkrahja e përpunimit të publikimit të parë të BPV-se tremujore, 2010-tremujori 1 i 2014 (veprimi 2.5 dhe 2.6)

Veprimet, që duhet ndërmerren për misionin tjetër – Plotëso dhe shto tabela sipas nevojës.

Veprimi	Afati	Personi Përgjegjës

Aneks1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.1.1 Vlerësimi dhe azhurnimi i Planit të Veprimit

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 11 Dhjetor 2013

Fillimi / fund i aktivitetit: 6-10 Janar 2014

Koha e raportimit: 24 Janar 2014

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.1.1	Vlerësimi dhe azhurnimi i planit të veprimit	- Raporti i misionit i publikuar në faqen e internetit të projektit - Plani i veprimit i Llogarive Kombëtare të Kosovës i azhurnuar duke përfshirë planin operativ/programi min e zhvillimit të aktivitetëve në pikën 2.2	- Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i azhurnuar	- Kapacitet i mjaftueshëm absorbimi - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve - Qasje në statistika primare të qarta - Termat e references, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, (inputi), rezultat e pritura,

				pjesëmarrësit ne aktivitet dhe agjendën
--	--	--	--	---

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 2.1.1

Konsultimi dhe diskutimi me divizionin e Llogarive Kombëtare. Intervistat me subjekte relevante vendore për të konfirmuar prioritetet e planit të veprimit ekzistues të Llogarive Kombëtare.

Rezultate e pritura nga aktiviteti 2.1.1:

Raporti i misionit. Plani i veprimit i azhurnuar për llogaritë kombëtare në Kosovë, duke përfshirë planin operativ dhe planifikimin e aktiviteteve në 2.2.

Resurset e ASK-së:

Mrs. Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevrie.Fetahu@rks-gov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Illir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Illir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krap, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapi@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarite Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Ms Clementina Ivan-Ungureanu, Ekspert, Statistikat e Danimarkës, iu_clem@yahoo.com

Mr Timmi Roelle Gravesen, Ekspert i Llogarive Kombëtare, Statistikat e Danimarkës, trg@dst.dk

Resurset e Projektit të Binjakëzimit:

Mr Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Ms Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaroi në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK me mbështetjen e IPA përgatiti një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave të plota për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare. Megjithatë, duket se Plani i Veprimit tashmë ka nevojë për një azhurnim të plotë, për shkak të shumë veprimeve të rëndësishme që janë planifikuar për vitin 2011 të cilat nuk mund të përmbushen. Është e rekomanduar për më tepër që plani duhet të jetë më shumë i përgatitur në formën e një plani operativ afatmesëm, i cili do të përfshinte caktimin e objektivave dhe prioritetëve të qarta në përputhje me kërkesat e përdoruesve kryesorë, duke përfshirë dhe Komisionin Evropian. Duhet të jepen detaje për aktivitetet që do të kryhen me përkrahjen e projekteve të asistencës, rezultatet e aktiviteteve dhe piketat (të paktën dy piketa në vit për secilin aktivitet) në të cilat duhet të jepen rezultatet konkrete, së bashku me një sistem për monitorimin e përmbushjes së aktiviteteve.

Projekti i Binjakëzimit do të ketë një aktivitet për azhurnimin e planit të veprimit dhe asistimin e ASK-së në zgjerimin e planit të veprimit në një plan operativ afatmesëm. Aktiviteti do të realizohet në tremujorin e parë të projektit. Në fund të projektit do të ketë një aktivitet për vlerësimin e rezultateve të punës së bërë gjatë realizimit të projektit dhe planifikimin e zhvillimit të Llogarive

Kombëtare në Kosovë pas Projektit të Binjakëzimit. Në tremujorin e pestë mund të merret në konsideratë një aktivitet për specifikimin e mëtejshëm të aktiviteteve për pjesën tjetër të projektit.

Aktivitetet që duhet ndërmerren si përgatitjet për misionin:

- Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global (AGA)
- Plani i veprimit për përpilimin dhe publikimin e të gjitha statistikave në Llogaritë Kombëtare dhe tregun e punës.
- Programi i Statistikave Zyrtare 2013 -2017
- Plani i Zhvillimit Strategjik 2009- 2013

Aranzhimi i takimeve të nevojshme me subjektet relevante jashtë ASK-se:

Lista e takimeve me subjektet relevante jashtë ASK-se mund të përfshihet në programin e misionit

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për vitin e ardhshëm për përmirësimin e Llogarive Kombëtare.
- Zhvillimi i planit të detajuar për aktivitetet e Projektit të Binjakëzimit -

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim
- Plani i detajuar për aktivitetet e tjera të Projektit të Binjakëzimit në komponentin 2
- Versioni i azhurnuar i Planit të Veprimit të Llogarive Kombëtare – i gatshëm që të merret në konsideratë nga menaxhmenti i lartë i ASK-së

Aneksi 1. Programi, - Janar 2013

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	Hotel Sirius	08:00	RTA takon ekspertët në Hotel Sirius
	ASK	09:00	Planifikimi i javës
		09:30	ASK: Përshkrimi i Planit të Veprimit dhe i Llogarive Kombëtare në Kosovë
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Vendet anetare: Rregulloret e BE-së për Llogaritë Kombëtare
		12:00	Dreka
		13:15	VA: Llogaritë Kombëtare në shtetet anëtare të BE-së
		14:30	Pushim për kafe
		15:00	Krahasimi i burimeve të të dhënave dhe metodologjisë në ASK dhe vendet anëtare
		16:30	Konkluzionet preliminare
2	ASK	09:00-16:00	Vazhdim
3	ASK	09:00-16:00	Vazhdim
4	ASK	09:00	Shkrimi i raportit
		10:30	Pushim për kafe
		10:45	Vazhdim: Dakordimi për rekomandimet dhe afatet kohore
		12:00	Dreka
		15:00	Takim me udhëheqësin e projektit në ASK: rekomandimet, afatet kohore dhe programi i punës

5	KAS	09:00	Shkrimi i raportit
		10:30	Pushim për kafe
		10:00	Shkrimi i raportit
		12:00	Dreka
		13:15	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Llogaritë Kombëtare

Ilir Berisha, Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare,
Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare

ASN dhe regjistri i bizneseve

Hysni Elshani, Shef sektori në Statistikat e Biznesit dhe Muhamet Kastrati, ekspert

RTA Team:

Per Knudsen, RTA (Resident Twinning Adviser)

Nora Zogaj, Asistente e RTA